

STATUTI I SHOQERISE
"INVEST CONSTRUCTION & INDUSTRIES" SHPK

Bazuar, ne legjislacionin ne fuqi vecanerisht, bazuar ne nenet 68 e vijues te ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Per shoqerite tregetare" dhe ligjin nr. 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" ne dispozitat e Kodit Civil si dhe ne vullnetin e tij te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e Statutit vendosi te formoje shoqerine:

KREU 1
THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

NENI. 1
DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT

1. Sot ne date 13.03.2023, u themelua shoqeria me perjegjesi te kufizuar me emrin
"INVEST CONSTRUCTION & INDUSTRIES" SHPK
2. Themeluesit e shoqerise jane:
 - **SHEFIKAT NGJELA** atesia Jasin, i datelindjes 07.02.1956, lindur në Delvine dhe banues Tirane , madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, e identifikuar nga leternjoftimi personal ID me Nr; F65207034A
 - **ARDIAN GRABOVA** atesia Bashkim , i datelindjes 17.05.1967, lindur në Vlore dhe banues Tirane , madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i identifikuar nga leternjoftimi personal ID me Nr; G70517141U

NENI. 2
OBJEKTI I SHQERISE

Objekt kryesor i kesaj shoqerie do te jete:

1. Investimi dhe ndertim I pasurive te paluajtshme si Apartamente, Godina banimi , Komplekse Rezidenciale , Rezidencia Turistike , Troje , Toka , Ambjente sherbimi Tregetare, Industriale , Lokale , Dyqane .

Real Estate , Shit-Blerje , qera te pasurive te luajtshme dhe paluajtshme si Apartamente, Godina banimi , Rezidenciale , Turistike , Troje , Toka , Ambjente sherbimi Tregetare, Industriale, Lokale , Dyqane etj.

Marrjen në zotërim të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe menaxhimin e tyre si për vete ashtu edhe për të tretë me anë të blerjes, shitjes, ndërmjetësimit, dhënieve me qira, nënqira, ristrukturimit e zhvillimit; qiradhënen e pajisjeve, mobiljeve, kryerjen e shërbimeve administrative, utilitare, drita, ujë, gaz, telefoni dhe çdoj lloj shërbimi të



nevojshëm për menaxhimin e tyre si për vete ashtu edhe për të tretë. Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të ngjashëm apo të përafërt me të vetin. Gjithashtu, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji mund të lëshojë garanci, letra dëmshpërblimi dhe çdo garanci tjetër reale Lidhja e kontratave te sipermarjes si dhe zhvillimi I te gjitha aktivitetave te lidhura direkt me aktivitetin e ndertimit dhe ate qe ka lidhje me pasurine e paluajtshme ne per gjithesë perfshire aktivitetin e ndermjetesimit ne lidhje me pasurite e paluajtshme.

2. Projektim, studim , supervizim i punimeve te ndryshme te ndertimit civile dhe Tregtare, Investime ne pasuri te paluajtshme ne ndertime Rezidenciale banimi , Turistike ndertimin e Resorteve Turistike, ambiente sherbimi , ambiente sherbimi Industriale dhe Agrokulture.

3. Dhenia e konsulences dhe sherbimeve ndaj shoqerive, institucioneve publike dhe private. Ne vecanti, Konsulence fiskale, Ekonomike, Financiare, Juridike , Strategji industriale dhe ceshtje qe i bashkolidhen (duke perfshire ristrukturimin dhe riorganizimin e shoqerive / nderrmarrjeve), gjithashtu me sherbime konsulence ne lidhje me aleancat, joint venture, bashkimet, ndarjet, perqendrimet, blerja e shoqerive,pjesemarrje aksionere, ne shoqeri o dege shoqerish dhe ne pune te tjera te jashtzakonshme financiare, duke bere studime dhe analiza tregu, perpunim te planeve industriale,kerkimin e partnereve strategjike, organizimin e takimeve,konferencave dhe gjithçka eshte e nevojshme me qellim zhvillimin e ketyre sherbimeve te konsulences.

4. Blerje stoqe minerali,transport stoqesh minerali,import - eksport stoqe minerali,germime,transport mineralesh,inerte dhe industriale. shtrimin e te drejtave te administrimit dhe shfrytezimit, rehabilitimit, modernizimit, financimit, te minierave, impianteve dhe uzinave/fabrikave; Ndertimin e fabrikave te pasurimit te mineraleteve kryesisht te kromit e Hekur - Nikel. Blerjen, shitjen, shkembimin dhe drejtimin e fabrikave, komplekseve industriale, eksplorimin e makinerive dhe impianteve, transportimin dhe tregtimin e burimeve natyrore dhe burimeve te energjise elektrike dhe te materialeve energjitime dhe te derivative te tyre brenda kufizimeve te parashikuara nga ligji; Importin dhe eksportin e produkteve perfundimtare qe lidhen me prodhimin metalurgjik dhe te minierave; Blerjen, shitjen, shkembimin dhe pjesemarrjen ne shoqeri apo ne deget e tyre, te jatin e te marrin me qera dhe huaperdorje te pasurive industriale, urbane e rurale duke perfshire vendosjen e pasurive te paluajtshme ne pronesi te Shoqerise

5. veprime bankare dhe financiare te cfaredo lloji dhe natyre, duke perfshire krijimin e filialeve, degeve, agjensive dhe depozitave te mbajtura nga administratoret te nevojshme ose te dobishme per arritjen e objektivit te Shoqerise, si dhe te marre pjesë (ne menyre direkte apo indirekte) ne cfaredo shoqeri tjeter te huaj me objekt te ngjashem apo te lidhur me objektin e permendor me siper; Si dhe cdo veprimitari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te Shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Shoqeria mund te kryeje çdo aktivitet tjeter te nevojshem apo te dobishem per realizimin e qellimeve te shoqerise. Shfrytezim minerali (Fe-Ni) mineral i grupit I , II , III . Ruajtja dhe sigurimi i objekteve private ne pronesi te subjektit. Projektim, studim, supervizim i punimeve te ndryshme te ndertimit civile dhe jo

J

civile. Prodhim, perpunim, nxjerrje materiale inerte dhe beton, transport dhe tregetim i tyre brenda dhe jashte vendit, import eksport i tyre dhe i gjithe makinerive ne funksion te aktivitetit te nxjerjes dhe perpunimit te inerteve. Germime dhe transport dherash, Prodhim dhe furnizim betoni. Dhenia e konsulences dhe sherbimeve ndaj shoqerive, institucioneve publike dhe private. Ne vecanti, Konsulence fiskale, Ekonomike, Financiare, Juridike , Strategji industriale dhe ceshtje qe i bashklidhen (duke perfshire ristrukturimin dhe riorganizimin e shoqerive / nderrmarrjeve), gjithashtu me sherbime konsulence ne lidhje me aleancat, joint venture, bashkimet, ndarjet, perqendrimet, blerja e shoqerive,pjesemarje aksionere, ne shoqeri o dege shoqerish dhe ne pune te tjera te jashtzakonshme financiare, duke bere studime dhe analiza tregu, perpunim te planeve industriale,kerkimin e partnereve strategjike, organizimin e takimeve,konferencave dhe gjithcka eshte e nevojshme me qellim zhvillimin e ketyre sherbimeve te konsulences

6. Cdo aktivitet tjeter te lidhur me aktivitetin kryesor

7. Per te gjitha aktivitete qe kerkojne licenca te vecanta shoqeria do te angazhohet me prioritet per te plotesuar kerkesat e ligjeve te posacme Agjenci Imobiliare.

NENI. 3 KOHEZGJATJA

3.1 Kohezgjatja e shoqerise do te jetë pa afat .

3.2 Shoqeria mund te prishet ne cdo moment qe mund te vendoset prej Ortakeve

NENI. 4 SELIA E SHOQERISE

4.1 Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga Sami Frasherri ,Godina 13 ,hyrja 1, kati 8, apartamenti 29, Tirane , Shqiperi.

4.2 Transferimi i selise se Shoqerise ne nje vend tjeter behet me vendim e Asamblese se Ortakëve.

4.3 Asambleja e Ortakëve mund te vendose hapjen e Filialeve, degeve dhe perfaqesive te Shoqerise ne Qytete te tjera te Shqiperise si dhe jashte Saj.

KREU II KAPITALI

NENI. 5 KAPITALI I THEMELTAR

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise do te jetë 100.000 (njeqind mijë)lek i perbere nga 2(dy) kuota me vlore 100.000(njeqind mijë) Lek.

8

Pjesmarria e Ortakëve ne kapitalin e shoqerise do te jete:

- Ortakët :
- **SHEFIKAT NGJELA** zoteron 50% te kapitalit themeltar te shoqerise , e barazvlefshme me 50.000 (pesedhjete mijë)Lek
-
- **ARDIAN GRABOVA** zoteron 50% te kapitalit themeltar te shoqerise , e barazvlefshme me 50.000 (pesedhjete mijë)Lek

Kontributi i Ortakëve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme, apo te drejta)

**NENI. 6
ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet me vendim asambleje nga te pakten 75% e ortakeve te shoqerise nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kopetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Ne asnjë rast shumica nuk mund te detyroje një ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.

**NENI. 7
TRANSFERIMI I KAPITALIT**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:

- a. Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b. Shitblerjes
- c. Trashegimise
- d. Dhurimit
- e. Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve.

Pjeset e kapitalit themeltar jane te transferueshme me rruge trashegimije, sipas parashikimeve ligjore.

(F)

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

NENI. 8
ORGANET VENDIMMARRESE

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmares i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e per gjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a. Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise
- b. Ndryshimet e statutit
- c. Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d. Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e. percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
- f. Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g. Miratimi i bilanceve
- h. Zmadhim dhe zvogelim kapitali
- i. Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre
- j. Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k. Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- l. Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m. Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqsohet ne asamblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e per gjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 9
THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PER GJITHSHME

Asambleja e per gjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese

Kur asambleja e per gjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

(Signature)

(Signature)

NENI 10 KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e per gjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket, qe zoterojne me shume se 50 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, ose 75% jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese kuorumi te permendur ne paragrafin e mesiperm nuk arrihet , asambleja e per gjithshme, mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 11 MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e per gjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave ose 75% te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e per gjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtjen te tjera.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane **QKR** per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

NENI 12 PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e per gjithshme merr vendimin per:

- a. vleresimin e veprimitarise se tij
- b. shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c. ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- d. dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqsohet nga nje perfaqsues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interes , ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqson.

8

NENI 13 ADMINISTRIMI

Asambjela e pergjithshme emeron një ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte riperteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte ndaj pas regjistrimit ne QKR.

Personat e meposhtem caktohen si Administratori te shoqerise:

- Ardian GRABOVA, atesia Bashkim , i datelindjes 17.05.1967, lindur në Vlore dhe banues ne Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i identifikuar nga leternjoftimi me nr personal G70517141U.
- SHEFIKAT NGJELA atesia Jasin, i datelindjes 07.02.1956, lindur në Delvine dhe banues Tirane , madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, e identifikuar nga leternjoftimi personal ID me Nr; F65207034A

NENI 14 KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:

- a. Kryejne te gjitha veprimet e administritimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikat tregetare
- b. Perfaqesojne shoqerine ne te gjitha institucionet shteterore dhe private Brenda dhe Jashte teritorit te Shqiperise sipas vendimeve te asamblese per secilen cesh tj.
- c. Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
- d. Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim.
- e. Krijojne një sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f. Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit pas miratimit nga Asambleja e Pergjithshme.
- g. Raportojne para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimatrine e shoqerise
- h. Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statute .

1.Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se një administrator, ata e administrojnë shoqerine bashkerisht ne cdo veprim si organ kolegjial.

2.Asambleja e pergjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te

drejte. Padite qe lidhen me shperblimin e administratorit te shoqerise rregullohet sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

NENI 15 PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori eshte perjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Administratorret te cilet kane kryer veprime ose bere mareveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane perjegjes per demet e sjella shoqerise dhe perjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.

Pervec sa eshte parashikuar ne nenet 14,15, 17, dhe 18 te ligjit "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare", administratorret detyrohen:

- a. Te kryejne detyrat e tyre te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis.
- b. Te ushtrojne kopetencat qe i njihen me ligj dhe statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto.
- c. Te vleresoje me perjegjesi ceshtjet , per te cilat merret vendim.
- d. Te parandaloje dhe evitoje rastet e konfliktit aktual o te mundshem te interesave te tij me ato te shoqerise.
- e. Te ushtrojne detyrat e tij/tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem .

2. Administratorret gjate kryerjes se detyrave te tyre, perjigjen ndaj shoqerise per cdo veprim apo mosveprim qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregetare, me perjashtim te rasteve kur ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administratori vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 dhe 2 te ketij neni eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.

4. Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit.

Asambleja nuk mund te marre vendim te ndaloje ngritjen e kerkesë padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij .

**KREU IV
VITI FINANCIAR –EKSPERTET**

NENI 16 VITI FINANCIAR

Viti finaciar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor, Perjashtimisht , viti i pare finaciar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKR dhe mbylltet me 31 dhjetor.

f

**NENI 17
EKSPERTET**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregetare te shoqerise, ate gjithe vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne permbushje te kesaj detyre eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike et ushtruara te cilat eshte i detyruar qe tja paraqese dhe dorezoje ne kohe ortakeve per tu shqyrtuar e miratuar mbi baze ne te drejtes vendimore qe ka ne perpjestim me kuotat e tyre.

**KREU V
PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQUERISE**

**NENI 18
PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQUERISE**

Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
- b. Me vendimet e asamblese se Ortakeve.
- c. Me hapjen e procedurave te falimentit
- d. Nese nuk zhvillon aktivitet tregetar per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 Per Qendren Kombetare et Regjistrimit,
- e. Me vendim gjykate.

**NENI 19
RIORGANIZIMI I SHOQUERISE**

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhejs se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjt mbi shoquerite tregtare.

**NENI. 20
KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT**

Ortaket dhe administratoret e shoqerise me perguejegsi te kufizuar , nuk mund te mbajne pozicionin drejtues apo te jete te punesuar ne nje shoqeri qe ushtron aktivitet ne te njejten fushe me te paren

Ndalimi i pikes 1 mund te anulohet ne asamblene e pare te pergjithshme me $\frac{3}{4}$ e votave ne sipas dispozitave te neneve 87 dhe 145 te ligjt per shoquerite tregetare.

G



**NENI 21
LEGJISLACIONI**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2012 "Per tregetaret dhe shoqeritetregetare".

**NENI 22
MOSMARREVESHJET**

Per mosmarrveshjet midis ortakeve te shoqerise, ose shoqerise me te tretet, gjykata kopetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata Shqiptare.

**ORTAKET E SHOQERISE "INVEST CONSTRUCTION & INDUSTRIES"
SHPK**

SHEFIKAT NGJELA

Shefikat Ngjela
A. N.

ARDIAN GRABOVA

Ardian Grbova
JMK.